

Në bazë të nenit 33 paragrafi 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare dhe nevojës së ushtrimit të Biznesit, Qytetarët, tani Themeluesit Albert Hajdini, Mehedi Zejneli, Fatos Fondaj, Naser Shala dhe Merita Krasniqi më dt. 08/10/2013, lidhin :

AKTI I THEMELIMIT (MARRËVESHJA E INKORPORIMIT).

E SHOQËRISË TREGTARE “KATRORI ITS SH.P.K.” NË Graçanicë Adresa SUHODOLL, Magj. Prishtinë-Shkup, km. 10”, SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR (SH.P.K.)

Neni 1

Themeluesit pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshje do të themelojnë Shoqërinë e cila ka statusin juridik të Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar e në pajtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

Neni 2

EMËRTIMI I SHOQËRISË

2.1. Firma do të afrohet me emërtimin :

SHOQËRIA TREGTARE “KATRORI ITS Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

2.2. Emërtimi i shkurtuar :” “KATRORI ITS” SH.P.K.

Neni 3

LLOJI I SHOQËRISË DHE ADRESA

Shoqëria ka statusin juridik : Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar

Adresa e selisë është në “Graçanicë SUHODOLL, Magj. Prishtinë-Shkup ,km.10 “ .

Person i Autorizuar është “Naser Shala”.

Neni 4

PERIUDHA E KOHËZGJATJES

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë si sh.p.k. do të jetë në afat të pacaktuar.

Neni 5

QËLLIMI I THEMELIMIT TË SHOQËRISË

Qëllimi i themelimit të Shoqërisë është qëllim i ligjshëm afarist, si dhe përfitimi personal dhe ndihma vendit ku jetojnë me kontribute dhe taksa të ndryshme.

Neni 6

AKSIONARËT E SHOQËRISË

7.1. Aksionarët e shoqërisë mund të jenë persona fizik ose juridik, që kanë vënë ose do të kenë në zotërim aksione të shoqërisë, me të gjitha mënyrat e parashikuara me ligj.

7.2. Pronësia mbi aksionet e shoqërisë, përmban aderimin me të drejta të plota në statusin e shoqërisë përmes përfaqësimit në Kuvendin e aksionarëve.

Neni 7

TË DREJTAT DHE DETYRAT E AKSIONARËVE

8.1. Çdo aksionar, ka të drejtën e pjesëmarrjes në fitimet e shpërndashme të shoqërisë dhe përfiton proporcionalisht me shumën e aksioneve që zotëron .

8.2. Çdo vonesë në derdhjen e shumave të duhura nga shumat e pashlyera të aksioneve sjell pagimin e interesave, me përqindjet ligjore dhe kjo pavarësisht nga veprimet personale që shoqëria mund të ushtroj ndaj aksionarit që nuk ka shlyer detyrimin dhe nga masat e zbatimit të detyruar të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 8

DREJTORI

9.1. Drejtori i Shoqërisë emërohet: “ Naser Shala” nga “Prishtina “ Adresa: Rr. Ahmet Krasniqi Hy. VIII Nr. 01/01 Prishtinë i cili do të ushtroi funksionet e tij nën kontrollin e Kuvendit të aksionarëve.

9.2. Drejtori mund të shkarkohet për shkaqe të cenimit të ligjit nga Kuvendi i aksionarëve. Si shkaqe të cenimit të ligjit konsiderohen veçanërisht një faj i rëndë i Drejtorit, paaftësia e tij në kryerjen korrekte të funksioneve ose kur Kuvendi humb besimin tek ai.

Neni 9

KOMPETENCAT

Drejtori ka kompetenca të përcaktuara me Statut për të vepruar në çdo rrethanë në emër të shoqërisë, kompetenca që i ushtron brenda aktivitetit të shoqërisë.

Neni 10

THEMELUESIT

Themelues të “Katrori ITS”. në “Graqanicë “ janë:

1. Albert Hajdini, me adresë: Rr. Muharrem Ferjza Bll 3-Nr-18 Lagja e Spitalit Prishtine
2. Mehedi Zejneli, me adresë: Zaplluxhë Dragash
3. Fatos Fondaj me adresë Rr. Hasan Jashri C-11/A4 Nr. 29
4. Naser Shala me adresë Rr. Ahmet Krasniqi Hy. VIII Nr. 01/01 Prishtinë
5. Merita Krasniqi me adresë Rr. Lidhja e Lezhes 31 Prishtinë

Neni 11






PROCEDURAT ME TË CILAT NDRYSHOHEN RREGULLORET

Përveç Statutit, shoqëria do të nxjerr edhe akte tjera normative të cilat do të ndihmojnë punën e shoqërisë.

Mënyra e ndryshimit të rregulloreve do të jetë e ngjashme me atë të nxjerrjes së rregulloreve.

Më dt: 08/10/2013

Themeluesit :

1. Albert Hajdini, 
2. Mehedi Zejneli, 
3. Fatos Fondaj, 
4. Naser Shala 
5. Merita Krasniqi 



IT is not only knowledge, IT is passion.

Në përputhje me kërkesat nga neni 33 i Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare në Kosovë, , pronarët e “Katrori ITS” sh.p.k., Merita Krasniqi, Naser Shala, Albert Hajdini, Fatos Fondaj dhe Mehedi Zejneli me datë: 18/10/2013, nxjerrin:

STATUT

I

“KATRORI ITS” SH.P.K.

Katrori ITS - Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
Graçanicë

Neni 1

Dispozitat e Përgjithshme

1.1. Me këtë Statut rregullohen këto çështje :

- Emërtimi i Shoqërisë,
- Lloji i shoqërisë,
- Adresa e selisë së saj,
- Periudha e kohëzgjatjes,
- Veprimtaria e shoqërisë,
- Llojet e aksioneve të autorizuara për emetim, vlerën e tyre nominale, numrin dhe të drejtat e bartësve të tyre,
- Organet drejtuese,
- Emrat dhe adresat e themeluesve,
- Ndryshimet Statutoëre,
- Aktet e Ndërmarrjes,
- Procedurat e ndryshimit dhe plotësimit të Statutit,
- Dispozitat Përfundimtare.

1.2. Ky statut ka gjithashtu për qëllim, integrimin dhe gjithë përfshirjen e të gjitha çështjeve të cilat janë rregulluar me anë të Aneks Statuteve dhe Statutit të Kompanisë, në të kaluarën.

Neni 2

Struktura e Aksionarëve dhe Kapitali Themeltar

- 2.1. Shuma e kapitalit themeltar të Kompanisë është 1,000.00 (me shkronja: Njëmijë) Euro. Kapitali është i ndarë në 100 aksione në vlerë prej 10 (me shkronja: Dhjetë) Euro për secilin aksion.
- 2.2. Struktura e Aksionarëve do të jetë si në tabelën në vijim:

Emri i Aksionarëve	Pjesëmarrja në %	Nr. Aksioneve	Vlera e një Aksioni	Vlera e Aksioneve në Total
Merita Krasniqi	51 %	51	10	510
Naser Shala	12.25 %	12.25	10	122.5
Albert Hajdini	12.25 %	12.25	10	122.5
Fatos Fondaj	12.25 %	12.25	10	122.5
Mehedi Zejneli	12.25 %	12.25	10	122.5

Neni 3

Emërtimi i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar

- 3.1. Emërtimi i plotë i shoqërisë është Shoqëria Tregtare “Katrori ITS” Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar.
- 3.2. Shkurtimeisht shoqëria tregtare do të njihet si “Katrori ITS” SH.P.K.
- 3.3. Shoqëria Tregtare është Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar shkurtimeisht, **SH.P.K.**

Neni 4

Adresa e Selisë

- 4.1. Selia e “Katrori ITS” sh.p.k. është në Magjistralla Prishtinë-Shkup, km. 10, Graçanicë.
- 4.2. Person i autorizuar i kësaj shoqërie tregtare është Naser Shala, i cili është person i ligjshëm për pranimin e shërbimeve, njoftimeve, kërkesave si dhe akteve tjera që dërgohen nga autoritetet publike.
- 4.3. Shoqëria mund të themeloj filiale, zyra përfaqësimi brenda vendit në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 5

Qëllimi i Themelimit të Shoqërisë

Qëllimi i themelimit të Shoqërisë është qëllim i ligjshëm afarist si, përfitimi personal dhe ndihma vendit ku jetojnë, me kontribute dhe taksa të ndryshme

Neni 6

Periudha e kohëzgjatjes së shoqërisë

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë Tregtare si Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar do të jetë në afat të pacaktuar.

Neni 7

Veprimtaria e Shoqërisë

- 7.1. Veprimtaria e shoqërisë është si në vijmë:

5829	Publikimi i softuerëve të tjerë	Primarë
6311	Përpunimi i të dhënave, hostimi i informacionit dhe aktivitetet e lidhura me to	

7022	Aktivitetet e këshillimit për biznes dhe këshillat e tjera për manaxhim
4666	Tregtia me shumicë e makinerive dhe pajisjeve të tjera të zyrave
6209	Teknologjia tjetër informative dhe aktivitetet shërbyese kompjuterike
6202	Aktivitetet e këshillimeve kompjuterike
4778	Tregtia me pakicë e mallrave të tjera të reja, në dyqane të specializuara
9529	Riparimi i artikujve personal dhe shtëpiakë p.k.t.
7733	Marrja dhe dhënia me qira (lizingu) e makinerisë dhe pajisjeve të zyrave (përfshirë kompjuterët)
7112	Aktivitetet e inxhinierisë dhe këshillimit teknik
4690	Tregtia me shumicë jo e specializuar
4762	Tregtia me pakicë e gazetave dhe materialit të shkrimit, në dyqane të specializuara
9511	Riparimi i kompjuterëve dhe pajisjeve periferike
4799	Tregtia tjetër me pakicë, jo në dyqane, tezga ose tregje
7219	Kërkime dhe zhvillime të tjera eksperimentale në shkencat natyrore dhe inxhinieri
7320	Hulumtimi i tregut dhe matja e opinionit publik (sondazhet)

7.2. Të gjitha veprimtaritë e Shoqërisë regjistrohen tek Zyra e Regjistrimit e cila vepron në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Neni 8 Themeluesit e Shoqërisë

8.1. Themeluesit e shoqërisë mund të jenë persona fizik ose juridik që kanë vënë ose do të kenë në zotërim aksione të shoqërisë, me të gjitha mënyrat e parashikuara me ligj.

8.2. Themelues të Shoqërisë Tregtare, Katrori ITS janë :

1. **Merita Krasniqi me Nr. Personal: 1004812952, adresë Rr. "Lidhja e Lezhes" K. Prishtinë.**
2. **Naser Shala me Nr. Personal: 1004133257, adresë Rr. "Ahmet Krasniqi" K. Prishtinë.**
3. **Albert Hajdini me Nr. Personal: 1004942341, adresë Rr. "Muharrem Fejza: K. Prishtinë.**
4. **Fatos Fonadaj me Nr. Personal: 1171648170, adresë Rr. "Tirana" K. Prishtinë.**
5. **Mehedi Zejneli me Nr. Personal: 1500309837, adresë Rr. "Ilmi Rakovica" K. Prishtinë.**

8.3. Pronësia mbi aksionet e shoqërisë, përmban aderimin me të drejta të plota në statutin e shoqërisë nëpërmes përfaqësimit në Kuvendin e Aksionarëve.

Neni 9 Të Drejtat dhe Detyrat e Aksionarëve

9.1. Interesat pronësore, që mund të quhen "aksion" në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar, janë njësitë në bazë të cilave bëhet ndarja e pronësisë në shoqëri.

9.2. Një interes pronësor në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar është pronë personale e pronarit dhe mund të bartet pjesërisht ose në tërësi, varësisht nga kufizimet e parapara në këtë Statut dhe kufizimet e tjera të përcaktuara në Marrëveshjen e Shoqërisë.

9.3. Themeluesit e shoqërisë janë përgjegjës për të gjitha borxhet e shoqërisë dhe detyrimet e tjera me të tëra asetet.

9.4. Të gjithë themeluesit apo ndonjëri prej tyre që ndërmarrin veprim në emër të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar duke bërë hapjen e xhirrollogarive bankare, blerjen dhe dhënien me qira të pronës, lidhjen e kontratave ose ndërmarrjen e detyrimeve tjera, janë bashkërisht dhe personalisht përgjegjës për pretendimet dhe detyrimet që lindin si rezultat i këtyre veprimeve.

9.5. Çdo aksionar ka të drejtën e pjesëmarrjes në fitimet e shpërndahem të shoqërisë dhe përfiton proporcionalisht me shumën e aksioneve që zotëron.

9.6. Çdo vonesë në derdhjen e shumave të duhura nga shumat e pashlyera të aksioneve sjell pagimin e interesave, me përqindjet ligjore dhe kjo pavarësisht nga veprimet personale që shoqëria mund të ushtroj ndaj aksionarit që nuk ka shlyer detyrimin dhe nga masat e zbatimit të detyruar të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 10

Organet Drejtuese të Shoqërisë

10.1. Organet drejtuese të shoqërisë janë :

1. Kuvendi i Aksionarëve;
2. Drejtori Menaxhues.

10.2. Shoqëria Tregtare, sipas nevojës mund të krijoj dhe mbaj edhe një Bord të Drejtorëve.

Neni 11

Kuvendi i Aksionarëve

11.1. Kuvendi i Aksionarëve, qoftë i zakonshëm apo i jashtëzakonshëm, ka kompetenca dhe merr të gjitha vendimet e përcaktuara me Ligjin për Shoqëritë Tregtare ose Statutin e Kompanisë.

11.2. Kuvendi i Aksionarëve do të mbahet në zyrën e regjistruar të shoqërisë ose në një vend tjetër të caktuar më parë me paralajmërimin për mbledhje.

Neni 12

E drejta e votës

12.1. E drejta e votës rrjedh nga zotërimi i aksioneve që përfaqësojnë dhe çdo aksion të jep të drejtën e të paktës një (1) votë.

12.2. E drejta e votës që rrjedh nga përfaqësimi ,kërkon një mandat përfaqësimi të shkruar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 13

Drejtimi i Mbledhjeve të Kuvendit

13.1. Thirrja e mbledhjes së Kuvendit bëhet :

- Përmes njoftimit të dërguar me letër rekomande në adresën e çdo aksionari me shpenzimet e shoqërisë apo
- Në mënyrë elektronike në email adresat e aksionarëve ku patjetër duhet konfirmimi.

13.2. Mbledhjet e Kuvendit të aksionarëve, drejtohen nga një Kryesues i caktuar nga Kuvendi.

13.3. Gjithashtu, mbledhjen e Kuvendit mund ta drejtojnë personat që kanë autorizim e në pajtueshmëri me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

13.4. Kryesuesi cakton një procesmbajtës për të mbajtur procesverbalin lidhur me pikat e rendit të ditës.

Neni 14

Procesverbalet e Mbledhjes së Kuvendit

14.1. Procesverbalet e mbledhjes së Kuvendit, duhet të mbahen në përputhje me kërkesat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe detyrimisht në fund të saj, duhet të nënshkruhen nga Kryesuesi dhe Procesmbajtësi.

14.2. Kuvendi i jashtëzakonshëm mund të marr vendime të vlefshme vetëm në rast se aksionarët e pranishëm ose të përfaqësuar zotërojnë në mbledhjen e parë, të paktën $\frac{1}{2}$ e aksioneve dhe në të dytën $\frac{1}{4}$ e aksioneve me të drejtë vote. Në mungesë të këtij kuorumi mbledhja e dytë e Kuvendit mund të shtyhet për një datë të mëvonshme jo më të largët se dy muaj nga data e thirrjes së parë. Ajo merr vendim me një shumicë votash prej $\frac{3}{4}$ që u përkasin aksionarëve të pranishëm ose të përfaqësuar.

14.3. Kuvendi i zakonshëm merr vendime të vlefshme në mbledhjen e parë, vetëm nëse aksionarët e pranishëm ose të përfaqësuar zotërojnë $\frac{1}{4}$ e aksioneve me të drejtë vote. Në rast se kjo mbledhje nuk realizohet, në të dytën nuk kërkohet asnjë lloj kuorumi.

14.4. Kuvendi i zakonshëm merr vendim me shumicën e votave që zotërojnë aksionarët e pranishëm ose të përfaqësuar.

Neni 15

E drejta për të u njohur me dokumente

Drejtori duhet që të paktën, 8 ditë para ditës së caktimit të mbledhjes së Kuvendit, të i'u dërgojë aksionarëve, dokumentet e nevojshme për tu njohur dhe për të dhënë një gjykim të plotë, mbi administrimin dhe ecurinë e punëve të shoqërisë në fund të vitit, raportet mbi aktivitetin e shoqërisë, raportin e ekspertit të kontabilitetit, raportin e Këshillit Mbikëqyrës, të gjitha projekt, vendimet dhe konkluzionet si dhe të gjitha dokumentet tjera të parapara me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

Neni 16

Rritja dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar

16.1. Me vendim të Aksionarëve, kapitali themeltar i kompanisë Katrori ITS mund të rritet.

16.2. Me rastin e rritjes së kapitalit ndryshohet statuti i kompanisë, përmes aneks statutit.

16.3. Ashtu, siç bëhet rritja e kapitalit, me vendim nga mbledhja e aksionarëve mund të bëhet zvogëlimi i kapitalit të kompanisë.

Neni 17

Shpërbërja e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar dhe vendimi për Inicimin e Procedurës së Falimentimit

17.1. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar do të shpërbëhet, dhe Veprimtaria e saj Ekonomike do të përmbillet, në rast të:

1. Vendimit të Aksionarëve të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar për shpërbërjen vullnetare të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar.
2. Aksionarët miratojnë inicimin e procedurës sipas Ligjit për Falimentimin ose një ligji tjetër të aplikueshëm.

3. Nëse shpërbërja e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar bëhet sipas Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, veprimtaria ekonomike e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar përmbillet dhe asetet shpërndahen tek pronarët.

17.2. Inicimi i Shpërbërjes Vullnetare ose procedurës së falimentimit sipas Ligjit për Falimentimin nga aksionarët e kompanisë, bëhet përmes votimit unanimit.

Neni 18

Vazhdimi i Veprimtarisë Ekonomike pas Inicimit të Shpërbërjes Vullnetare

18.1. Pas shfaqjes së rrethanave ose vendimit për shpërbërje vullnetare sipas nenit 20 të këtij statuti dhe Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar vazhdon ekzistencën njëloj si më parë, por nuk mund të ushtrojë Veprimtari Ekonomike përveç atyre të nevojshme për shpërbërjen vullnetare dhe përmbylljen e veprimtarisë, të cilat përfshijnë:

- 1.1. Mbledhjen e të hollave ose asetëve që palë të ndryshme i'a kanë borxh Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar;
- 1.2. Pagimin ose aranzhimin për plotësimin e kërkesave të kreditorëve;
- 1.3. Shpërndarjen e asetëve të mbetura pas shitjes dhe përmbushjes së kërkesave të kreditorëve.

18.2. Këto aktivitete ushtrohen nga Drejtori Menaxhues të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, përveç nëse Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar emëron një profesionist të kualifikuar, qoftë person fizik ose juridik, për ushtrimin e këtyre aktiviteteve të cilët paguhen nga asetet monetare të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar dhe pagesa e të cilëve trajtohet si shpenzim administrativ sipas përcaktimeve në Ligjin në fuqi për Falimentimin.

Neni 19

Njoftimi i Shpërbërjes Vullnetare

19.1. Jo më vonë se pesë (5) ditë pune nga shfaqja e rrethanave ose vendimit për shpërbërje vullnetare, Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar duhet të dorëzojë në ARBK "Njoftimin për Shpërbërjen Vullnetare". Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar nuk duhet të shes ose shpërndajë cilëndo nga asetet e saj së paku tridhjetë (30) ditë pas ditës së dorëzimit të njoftimit në ARBK.

19.2. Procedura për shpërbërje vullnetare zhvillohet në tërësi konform Ligjit Nr.06/L-016 për Shoqëri Tregtare.

Neni 20

Shpërndarja e Aseteve të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar gjatë Shpërbërjes Vullnetare

Gjatë shpërbërjes vullnetare, asetet e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar do të paguhen dhe ose shpërndahen sipas prioriteteve të përcaktuara në Ligjin në fuqi për Falimentim.

Neni 21

Revokimi i Njoftimit për Shpërbërje Vullnetare

21.1. Përfaqësuesi i Autorizuar apo Drejtori Menaxhues mund ta revokojë Njoftimin e Shpërbërjes Vullnetare brenda afatit prej nëntëdhjetë (90) ditësh nga dita e dorëzimit të Njoftimit për Shpërbërjen Vullnetare.

21.2. Ky revokim duhet të autorizohet në të njëjtën mënyrë sikurse edhe Njoftimi për Shpërbërje Vullnetare.

21.3. Për hyrjen në fuqi të këtij revokimi, një përfaqësues i autorizuar duhet të nënshkruajë dhe të dorëzojë në ARBK Njoftimin për Revokimin e Shpërbërjes Vullnetare sipas dispozitave ligjore që përcakton Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare.

Neni 22

Ekzekutimi i kërkesave të kreditorëve ndaj Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar që i është nënshtruar shpërbërjes vullnetare

Kërkesat e kreditorëve ndaj një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar që i është nënshtruar shpërbërjes vullnetare mund të ekzekutohen sipas Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare.

Neni 23

Drejtori Menaxhues

23.1. Drejtor Menaxhues i Shoqërisë emërohet z. Naser Shala i cili do të ushtroi funksionet e tij nën kontrollin e Kuvendit të Aksionarëve.

23.2. Drejtori ka këto kompetenca që ta përfaqësojë Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar si Përfaqësues i Autorizuar gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj ekonomike, duke përfshirë edhe autorizimin:

- Për udhëheqjen e Veprimtarisë së zakonshme Ekonomike të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar; dhe për nënshkrimin e marrëveshjeve ose dokumenteve tjera të nevojshme për ushtrimin e Veprimtarisë Ekonomike në emër të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar nëse ky nënshkrim ndërlidhet në masë të arsyeshme me ushtrimin e veprimtarisë së zakonshme Ekonomike të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar.
- Të ekzekutoi Vendimet e Kuvendit;
- Të udhëheq afarizmin e shoqërisë;
- Të organizon dhe udhëheq me procesin e punës;
- Përgatit pasqyrat vjetore të kontabilitetit dhe raportet mbi afarizmin;
- Propozon Vendimet të cilat i nxjerr Kuvendi;
- Propozon organizimin e brendshëm të shoqërisë;
- I pranon në punë dhe iu shkëput Kontratën e punës punëmarrësve;
- Vendos mbi sistemimin e punëmarrësve në vende pune ;
- Kujdeset për ligjshmërinë e punës në shoqëri;
- Vendos mbi procedurat disiplinore të të punësuarve;
- Kryen edhe punë të tjera në harmoni me Ligjin, Statutin dhe Vendimet e Kuvendit.

23.3. Drejtori, si përfaqësues i shoqërisë është i autorizuar të lidh Kontrata dhe kryej të gjitha veprimet tjera juridike pa kurrfarë kufizimesh.

23.4. Cilido person, përfshirë Drejtorin Menaxhues, i cili me dijeni pretendon se vepron në emër të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar në shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 23 të këtij statuti, është personalisht përgjegjës për të gjitha që i janë shkaktuar Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar nga këto veprime.

23.5. Drejtori mund të shkarkohet për shkaqe të cenimit të ligjit nga Kuvendi i Aksionarëve.

23.6. Si shkaqe të cenimit të ligjit konsiderohen veçanërisht:

- një faj i rëndë i Drejtorit;
- pa aftësia e tij në kryerjen korrekte të funksioneve;
- kur Kuvendi i Aksionarëve humb besimin tek ai
- rastet e tjera të parapara me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

Neni 24

Përgjegjësia e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar

24.1. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar është përgjegjëse për të gjitha borxhet e saj dhe detyrimet tjera me të gjitha asetet e saj.

24.2. Një aksionar i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar nuk është përgjegjës për borxhet ose detyrimet e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar vetëm për arsye se është aksionarë.

24.3. Nga ana ligjore, Shoqëria përfaqësohet nga drejtori, personi fizik apo juridik që Drejtori Menaxhues e autorizon.

Neni 25

Ndarja, Bashkimi dhe Likuidimi i Shoqërisë

25.1. Shoqëria mund të ndahet, bashkohet, likuidohet ose transformohet në një formë tjetër, përpara afatit të përcaktuar, me vendim të mbledhjes së jashtëzakonshme të aksionarëve, në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare.

Neni 26

Dispozitat Përfundimtare

26.1. Ky Statut hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e pronarëve të Katrori ITS SH.P.K.

26.2. Ndryshimet dhe plotësimet e këtij Statuti bëhen përmes Aneks-Statuteve, sipas procedurës së njëjtë siç është aprovuar ky statut.

26.3. Për të gjitha çështjet që nuk janë përcaktuar me këtë Statut, do të aplikohen dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare të Kosovës.

Datë: 08/10/2013, Graçanicë

Themeluesit dhe Aksionarët "Katrori ITS" Sh.p.k.

1. Merita Krasniqi _____

2. Naser Shala _____

3. Albert Hajdini _____

4. Mehedi Zejneli _____

5. Fatos Fondaj _____